REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 60 prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/10 / 2026

VENDIM

Nr. 4 datë 30 / 10 / 2026

PËR

PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT

Mbi "Ndërhyrjen emergjente për riparimin e Digës së Kallmetit", Bashkia Lezhë

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.10.2026 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga Bashkia Lezhë për projektin "Ndërhyrje emergjente për riparimin e Digës së Kallmetit". Projekti është pregatitur nga firma konsulente "Zeta Konsult sh.p.k" e dorëzuar në SKDM nga Bashkia Lezhë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projekti nuk ka plotësuar kërkesat e legjislacionit përkatës. Në këtë dokumentacion mungojnë llogaritjet e qëndrushmërisë së trupit të digës, funksionimi i sistemeve të filtrimit dhe drenazhimit, shkaqet e difekteve të skarpatave dhe masat për eleminimin e tyre, kapacitetet e vepres së shkarkimit dhe sigurinë hidraulike, masat që garantojnë sigurinë e digës gjatë zbatimit dhe pas rehabilitimit.

Projekti nuk është i **shoqëruar nga detyra e projektimit dhe oponenca teknike, ku është domosdoshmeri paraqitja e tyre, theksojmë që projekti duhet të sillet zyrtarisht i printuar** dhe shoqëruar me (CD) dhe i firmosur sipas kërkesave të nenit 10 të VKM së mësipërme.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) pas diskutimit dhe shqyrtimit nga ana teknike i rekomandoi KKDM, që dokumentacioni teknik nuk është i plotë dhe nuk përmban argumentimin dhe informacionin e nevojshëm për të vlerësuar në mënyrë të plotë përshtatshmërinë e zgjidhjeve të propozuara, si dhe garantimin e kushteve të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së digës.

Pas diskutimeve të të gjithe antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

Të mos miratoj Projektin e paraqitur nga Bashkia Lezhë, "Ndërhyrje emergjente për riparimin e Digës së Kallmetit", për shkak të mungesave të konstatuara në dokumentacionin teknik në (CD).

Ti kërkohet Bashkisë Lezhë si shfrytëzuese e digës Kallmet, plotësimi dhe argumentimi teknik si më poshtë:

1. Të paraqitet detyra e projektimit dhe oponenca teknike e projektit.
2. Të paraqiten rezultatet e studimeve gjeologjike, gjeoteknike, gjeofizike dhe sizmike.
3. Të llogaritet qëndrueshmëria e trupit të digës në gjëndjen ekzistuese, përcaktimin e shkaqeve të filtrimeve dhe të jepen masat që duhet të meren në rastet që do të jetë e nevojshme.
4. Sistemin e drenazhimit, funksionimin e tij dhe përshtatshmërinë e zgjidhjes së propozuar.
5. Tw parashikohet dhe instalimi i instrumentave matws pwr digwn si: instrumenta pwr matjet gjeodezike dhe kapwrderdhws pwr matjet e filtrimeve nw biefin e poshtwm.
6. Të jepen punimet për shkarkuesin dhe ujëlëshuesin, përfshirë verifikimin e kapacitetit dhe funksionimit të tyre.
7. Kanalin ujitës që kalon në trupin e digës: të studiohet dhe projektohet një vepër e veçantë, me trase jashtë trupit të digës, duke verifikuar ndikimin e zgjidhjes në sigurinë e digës.
8. Në dokumentacionin teknik të projektit, të përfshihet përputhshmëria e specifikimeve teknike me preventivin e punimeve.

Të kërkohet nga subjekti projektues plotësimi i dokumentacionit dhe argumentimi i çështjeve teknike të evidentuara më sipër, si dhe paraqitja e dokumentacionit të rishikuar për një shqyrtim të mëtejshëm teknik. Duke pasur parasysh karakterin emergjent të problematikave të evidentuara, strukturat përgjegjëse për administrimin e digës të marrin masa të menjëhershme për monitorimin e gjendjes së veprës dhe garantimin e sigurisë së saj, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Ju faleminderit për Mirëkuptimin

Me respekt,

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Ardian ISLAMI